



Фонд за здравствено осигурување на Република Северна Македонија  
Fondi për sigurim shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Shkup

26.06.2020

**NJOFTIM**

**për nënshkrim me çertifikatë të kualifikuar digjitale (token) të  
farmacistit/teknikut farmaceutik gjatë lëshimit të ilaçit me eRecetë**

Me Ligjin e të Dhënave në Formë Elektronike dhe Nënshkrimin Elektronik, është rregulluar që përgjithësisht nënshkrim i pranuar elektronik është një nënshkrim elektronik nëse: ai është i lidhur ekskluzivisht vetëm me nënshkruesin dhe mund të vërtetohet nga nënshkruesi. Nënshkrim përgjithësisht i pranuar elektronik me çertifikatë të kualifikuar të lëshuar në lidhje me të dhënat elektronike është barazuar me nënshkrimin personal dhe për këtë arsye ka vlefshmëri dhe forcë të provës, si një nënshkrim personal i shkruar me dorë lidhur me dokumentet prej letre.

Për këtë arsye, gjatë lëshimit të çdo ilaçi veçmas, me recetë në ngarkesë të Fondit, farmacistët/teknikët farmaceutikë duhet të nënshkruajnë eRecetën me çertifikatë të kualifikuar digjitale (token), me qëllim që të mundësohet vlefshmëria e recetave elektronike. Prandaj, është e nevojshme që secili pjesëmarrës në procesin e lëshimit të ilaçeve të sigurojë një **çertifikatë të kualifikuar digjitale (token)** sa më shpejt që është e mundur.

Njëkohësisht, theksojmë se prezentimi i vulës elektronike dhe lidhja e nënshkrimit elektronik me kohën e përshkrimit të ilaçit të eRecetës do të kalojë përmes sistemit të Fondit. Prandaj, farmacia nuk ka nevojë të furnizohet me vulë elektronike dhe as vulë kohore.

Mënyra e nënshkrimit elektronik dhe verifikimi me çertifikatë të kualifikuar digjitale (token) të eRecetës do të përshkruhet në detaje në Udhëzimin Teknik.